

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Lufta kundër korrupsionit përbën një ndër sfidat kryesore dhe prioritetet madhore të Shqipërisë në hapjen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, parashikuar në kuadër të udhërrëfyesit për 5 prioritet e rekomanduara nga Komisioni Evropian për vitin 2013, miratuar me vendimin nr.330, datë 28.5.2014, të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, parandalimi dhe ndëshkimi i korrupsionit është një detyrim që rrjedh nga aderimi i Shqipërisë në instrumentet ndërkombëtare për luftën kundër korrupsionit, si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit dhe Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit. Nga ana tjetër, në mbështetje të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020 dhe planit të veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2017, miratuar me vendimin nr.247, datë 20.3.2015, të Këshillit të Ministrave, përcaktohen konkretisht drejtimit kryesore të programit qeveritar lidhur me luftën kundër korrupsionit dhe objektivat në këtë fushë. Konkretisht, në bazë të objektivit A-4 kërkohet ngritja e mekanizmit për mbrojtjen e bilbilfryrësve/sinjalizuesve, si mjet për mbrojtjen e nëpunësve që tregojnë integritet të lartë dhe si mjet kontrolli i veprimtarisë shtetërore në kuadër të luftës kundër korrupsionit. Rrjedhimisht, bëhet i domosdoshëm hartimi i kuadrit ligjor për të përfituar nga kjo formë bashkëpunimi në ndjekjen e rasteve të korrupsionit.

Në mbështetje të sa më sipër, qëllimi i projektligjit është parandalimi dhe goditja e korrupsionit në sektorin publik dhe privat, mbrojtja e individëve që sinjalizojnë veprimet apo praktikave të dyshuara të korrupsionit në vendin e tyre të punës dhe nxitja e sinjalizimit të veprimeve apo praktikave të dyshuara të korrupsionit.

II.VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është në përputhje të plotë me programin e qeverisë, Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020 dhe planin e veprimit

të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2017, miratuar me vendimin nr.247, datë 20.3.2015, të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Individi që zbulon korrupsionin brenda organizatës së tij shpesh përballet me mosbesim, urrejtje, kundërshtime, hakmarrje dhe masa që kufizojnë mundësitë, të drejtat dhe pozicionet e tij. Mungesa e dëshirës për të zbuluar një të vërtetë ka disa arsye, që variojnë nga frika kolektive e pasojave të zbulimit, në mungesën e thjeshtë të interesit për të zbuluar të vërtetën. Është tepër e vështirë që të thyhet heshtja dhe të nxirret informacioni duke ditur që ky veprim do të dëmtojë seriozisht reputacionin, marrëdhënien bashkëpunuese, miqësinë, besimin e të tjerëve, pozicionin dhe funksionin brenda organizatës që ndoshta mund të ketë edhe dëme financiare për raportuesin. Raportuesi ka nevojë për ndihmë për të tejkaluar pasojat e veprimeve hakmarrëse që vijnë si rezultat i zbulimit dhe raportimit të veprimit apo praktikës së korrupsionit brenda organizatës. Ligji nr.9850, datë 3.4.2006, “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit”, megjithëse parashikon disa rregulla për nxitjen dhe pjesëmarrjen e publikut në denoncimin e korrupsionit, nuk ofron një mbrojtje të efektshme për këta persona dhe në praktikë nuk është zbatuar me efikasitet. Në këtë kuadër, ky projektligj sanksionon krijimin e një mekanizmi të ri denoncimi dhe goditje të veprimeve apo praktikave të dyshuara të korrupsionit në vendin e punës nga punonjësit e një autoriteti publik apo subjekti privat në Republikën e Shqipërisë (autoriteti publik apo subjekti privat bashkërisht referuar në projektligj dhe në këtë relacion si “organizata”).

Objekt i sinjalizimit janë veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni që konsistojnë në veprime ose mosveprime, fakte apo rrethana, të kryera në një organizatë, për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim, sipas këtij ligji, se mund të përbëjë vepër penale të korrupsionit. Sinjalizues do të jetë çdo individ i cili është në marrëdhënie pune apo ka punuar më parë pranë autoritetit publik apo subjektit privat, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës apo kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo dhe sinjalizon mbi fakte apo rrethana për të cilat vihet në dijeni gjatë punës apo në lidhje me veprimtarinë e tij të punës pranë organizatës. Nga ana tjetër, vepra penale të korrupsionit do të jenë ato veprime ose mosveprime të kundërligjshme sipas legjislacionit penal në fuqi në lidhje me çdo formë të korrupsionit aktiv dhe pasiv, shpërdorimin e detyrës ose të kompetencave, ushtrimin e ndikimeve të paligjshme në kryerjen e detyrave apo marrjen e vendimeve, shpërdorimin e të ardhurave të buxhetit të shtetit, përfitimin e paligjshëm të interesave, mitdhënien apo mitmarrjen, si dhe çdo akt tjetër të ngjashëm me sa më sipër. Ky përkufizim është hartuar në kuadër të Kodit Penal, por është konceptuar si një dispozitë e përgjithshme, përshkruese dhe joshteruese

për t'u paraprirë ndryshimeve të mundshme ligjore në të ardhmen në dispozitat penale të veprave të korrupsionit.

Projektligji sanksionon të drejtat e sinjalizuesit, si e drejta e konfidencialitetit gjatë procesit të sinjalizimit; ruajtja e konfidencialitetit të burimit të informacionit; ruajtja e sekretit shtetëror dhe mbrojtja kundër hakmarrjes.

Mekanizmi i sinjalizimit sipas projektligjit është i ndërtuar në dy shtylla kryesore: shtylla e parë është parashikimi i një procedure të re ligjore për hetimin e pretendimeve të sinjalizimit në lidhje me një veprim apo praktikë të dyshuar korrupsioni dhe shtylla e dytë është sanksionimi i masave mbrojtëse për sinjalizuesit nga çdo veprim hakmarrës i organizatës, i drejtpërdrejtë apo jo i drejtpërdrejtë, ose kërcënim i kryer nga organizata me natyrë diskriminuese, disiplinore apo që në një formë tjetër të padrejtë dëmton interesat e ligjshëm të sinjalizuesit dhe që rezulton nga sinjalizimi.

Shtylla e parë: shqyrtimi i sinjalizimit

Një nga risitë e projektligjit është detyrimi ligjor për ngritjen e njësisë së specializuar përgjegjëse, si organi i posaçëm caktuar brenda autoritetit publik ose subjektit privat, i ngarkuar nga organizata me detyrën e shqyrtimit dhe hetimit të sinjalizimit deri në pushimin e çështjes dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje të sinjalizuesit, sipas përcaktimeve të këtij projektligji. Njësia përgjegjëse mund të përbëhet nga një ose më shumë persona, sipas përbërjes dhe strukturës së organizatës, të trajtuar posaçërisht në fushën e mbrojtjes së sinjalizuesve. Ngritja e kapaciteteve të duhura pranë ILDKPKI-së dhe njësive përgjegjëse për të trajtuar një procedurë hetimi të sinjalizimit është një detyrim ligjor për këto struktura. Çdo organizatë, e cila nuk krijon njësitë përgjegjëse brenda afateve ligjore, dënohet me gjobë në vlerën 100 000 lekë.

Sinjalizim i veprimit apo praktikës së dyshuar të korrupsionit mund të kryhet nëpërmjet sinjalizimit të brendshëm tek njësia përgjegjëse e organizatës. Megjithatë, mbështetur në rekomandimet e Këshillit të Evropës mbi mbrojtjen e sinjalizuesve¹, duhet të krijohen alternativa të sinjalizimit të brendshëm për të garantuar të drejtat dhe mbrojtjen e sinjalizuesit aty ku kërcënohen nga sinjalizimi i brendshëm. Rrjedhimisht, Inspektorati i Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) është caktuar si organ i sinjalizimit të jashtëm.

¹ Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës nr.2014/7, datë 30.4.2014.

Gjithashtu, projektligji vendos mirëbesimin në themel të çdo sinjalizimi. Mirëbesimi do të jetë parimi i vetëm dhe i mjaftueshëm për vlerësimin e sinjalizuesit. Një garanci e shtuar për sinjalizuesin është fakti se mirëbesimi është i prezumuar në çastin e sinjalizimit, dhe se, parimisht, barra e provës për të kundërshtuar pretendimet i takon të sinjalizuarit². Pavarësisht se projektligji vendos standarde për vlerësimin e mirëbesimit në nenin 6, mirëbesimi nuk është përkufizuar në mënyrë shteruese në projektligj. Mbështetur edhe në rekomandimet e Këshillit të Evropës mbi mbrojtjen e sinjalizuesve, testi i mirëbesimit do të jetë subjektiv dhe do të gjykohet rast pas rasti.

Sipas frymës së projektligjit, njësia përgjegjëse apo ILDKPKI-ja do të fillojë të hetojë sinjalizimin kurdoherë kur plotësohen dy kushte: së pari sinjalizimi është bërë në mirëbesim; dhe së dyti, sinjalizuesi ka depozituar një sinjalizim në formë shkresore dhe sipas përmbajtjes së paracaktuar nga projektligji. Për të mos krijuar një kulturë të sinjalizimeve anonime të cilat cenojnë përforcimin e mekanizmit të sinjalizimit në përgjithësi, në kuadër të rekomandimeve të Këshillit të Evropës, sinjalizimi anonim do të pranohet vetëm në raste të veçanta në diskrecionin e vetëm të njësisë pritëse të sinjalizimit.

Projektligji parashikon se sinjalizimi është në çdo rast vullnetar. Kjo do të thotë se asgjë në këtë projektligj nuk pengon sinjalizuesin të zgjedhë të sinjalizojë sipas këtij projektligji, të njoftojë/të kallëzojë në prokurori/polici ose të bëjë publik rastin bazuar tek informacioni që zotëron. Por në rastin e sinjalizimit, njësia përgjegjëse apo ILDKPKI-ja do të ketë kapacitetet dhe autoritetin e nevojshëm për të mbledhur prova, aksesuar në dokumente apo bashkëpunuar me organizata të tjera pa detyruar sinjalizuesin të bëjë publik burimin e tij të informacionit. Kështu pretendimet e sinjalizuesit, të cilat në të kundërt mund të mos ishin të mjaftueshme për të filluar një procedim penal sipas Kodit të Procedurës Penale, do të mund të arsyetohen dhe do të mbështeten nga njësia përgjegjëse/ILDKPKI-ja. Rrjedhimisht, ky mekanizëm do t'i vijë në ndihmë pikërisht edhe prokurorisë/policisë dhe do të përmbushë qëllimin e përbashkët për goditjen e korrupsionit.

Gjithashtu, edhe hetimi i sinjalizimit bazohet në parime që synojnë zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor hetimi, shkelja e të cilave përbën kundërvajtje administrative dhe passjell përgjegjësi ligjore për punonjësën apo organizatën. Këto janë: ndershmëria, paanshmëria dhe efikasiteti; pavarësia nga pikëpamja politike dhe çdo influencë tjetër e padrejtë që mund të pengojë realizimin e detyrave sipas këtij projektligji; shmangia e konfliktit të interesave dhe detyrimi i punonjësve të njësisë përgjegjëse për të deklaruar konfliktin e interesit në lidhje me një

² Personit ndaj të cilit bëhet një sinjalizim sipas këtij ligji në lidhje me një veprim apo praktikë të dyshuar korrupsioni.

sinjalizim; mbrojtja e dokumentacionit dhe provat lidhur me sinjalizimin nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime të tjera të cilat synojnë asgjësimin e tij; ruajtja e konfidencialitetit të informacionit, ruajtja e sekretit shtetëror (në zbatim të ligjit të posaçëm) dhe mbrojtja e të dhënave në përmbajtje të çdo sinjalizimi.

Mënyra e garantimit dhe sigurimit të paanshmërisë së njësisë përgjegjëse duhet të shqyrtohet dhe të vlerësohet rast pas rasti. Për më tepër, ILDKPKI-ja, e cila do të monitorojë nga afër zbatimin e projektligjit duke nxjerrë edhe akte nënligjore dhe rregullore për këtë qëllim, do të duhet të rregullojë nëpërmjet këtyre akteve mënyra dhe tregues konkretë të ruajtjes së paanshmërisë së punonjësve të njësisë përgjegjëse. Nga ana tjetër, nëse provohet se është shkelur paanshmëria, ILDKPKI-ja vendos gjobë sipas nenit 21(1)(c) të projektligjit.

Së fundi, për të shmangur çdo konfuzion në lidhje me gjykimin e elementeve të veprës penale si një procedurë ekskluzive e organeve të ndjekjes penale apo gjykatës, neni 13(3) i projektligjit parashikon se njësitë përgjegjëse apo ILDKPKI-ja përqendrohen në shqyrtimin dhe vlerësimin e pretendimeve të ngritura nga sinjalizuesi në lidhje me veprimin apo praktikën e dyshuar të korrupsionit. Kur gjatë hetimit rezulton se sinjalizimi mbi veprimin apo praktikën e dyshuar të korrupsionit është i bazuar, njësia përgjegjëse apo ILDKPKI-ja pushon çështjen dhe njofton menjëherë prokurorinë apo policinë. Ndërsa mbi masat e marra lidhur me shkeljet administrative, kufiri i ndërhyrjes sipas projektligjit është i qartë pasi njësia përgjegjëse e një autoriteti publik apo ILDKPKI-ja, kur rezulton se veprimi apo praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën apo mund të përbëjë edhe një shkelje administrative sipas ligjit, njësia përgjegjëse apo ILDKPKI-ja sipas rastit do të vërë në dijeni organin kompetent. Pra, projektligji kufizohet të përdorimi i këtij konstatimi për të aktivizuar pikërisht organet kompetente administrative apo penale të cilat trajtojnë çështjen sipas ligjit të zbatueshëm.

Shtylla e dytë: mbrojtja nga hakmarrja

Një ndër risitë që sjell projektligji është parashikimi i mbrojtjes së sinjalizuesit nga veprimet hakmarrëse të organizatës së tij. Sinjalizuesi paraqet fillimisht kërkesë për mbrojtje nga këto akte tek njësia përgjegjëse. Në rast se njësia përgjegjëse nuk merr menjëherë masa, kërkesa paraqitet te ILDKPKI-ja e cila vijon me procedurën e parashikuar gjithashtu në projektligj për shqyrtimin e pretendimit të një akti hakmarrjeje.

Veprimet e hakmarrjes mund të jenë pa kufizim: shkarkim nga puna; pezullim nga puna ose të një apo më shumë detyrave; transferim brenda apo jashtë organizatës; ulje në detyrë; ulje e pagës dhe/ose shpërblimeve financiare; humbje e statusit dhe privilegjeve; mosngritje në detyrë; heqje e së drejtës për të marrë pjesë në trajnime;

vlerësime negative në marrëdhënien e punës; forma të tjera të hakmarrjes në lidhje me punën.

Mekanizmat në dispozicion të sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja janë: akti i hakmarrjes konsiderohet i pavlefshëm dhe se sinjalizuesi mund të vendoset në një strukturë tjetër të organizatës për të ruajtur veten nga reagime armiqësore në mjedisin e tij të afërt të punës me urdhër të ILDKPKI-së. Në lidhje me paligjshmërinë e aktit të hakmarrjes ndaj sinjalizuesit formalizuar si akt administrativ, vetë neni 108 (ç) i Kodit të ri të Procedurave Administrative (i cili pritet të hyjë në fuqi përafërsisht në kohën e fillimit të zbatimit të projektligjit), parashikon se akti administrativ është “*absolutisht i pavlefshëm në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj*”. Të njëjtin qëndrim mban edhe Kodi i Procedurave Administrative në fuqi. Nga ana tjetër, si për shembull edhe në rastet e largimit nga puna sipas Kodit të Punës, i ndryshuar, pushimi nga puna për shkaqe të paarsyeshme është i pavlefshëm.

Megjithatë, pavlefshmëria e aktit të hakmarrjes sanksionuar në projektligj është gjithmonë i lidhur me mbrojtjen përfundimtare ofruar sinjalizuesit sipas këtij projektligji. Kështu, nëse në përfundim të hetimit rezulton së është kryer një akt hakmarrjeje ndaj sinjalizuesit nga autoriteti publik, ILDKPKI-ja i drejtohet organit kompetent sipas legjislacionit në fuqi për të urdhëruar autoritetin publik të marrë të gjitha masat për riparimin e shkeljes së kryer. Në këtë kuptim, organi kompetent mund të jetë si organi epror ashtu edhe i njëjti organ i administratës publike i cili ka tagër sipas ligjit për të revokuar një akt apo rishqyrtuar dhe korrigjuar veprimin e paligjshëm, sikurse është akti i hakmarrjes sipas përcaktimeve të këtij projektligji. Nëse në përfundim të hetimit rezulton së është kryer një akt hakmarrjeje ndaj sinjalizuesit nga subjekti privat, ILDKPKI-ja urdhëron subjektin privat të marrë të gjitha masat për riparimin e shkeljes së kryer. Nëse organi kompetent apo subjekti privat nuk merr masat e kërkuara nga ILDKPKI-ja sipas këtij paragrafi, çdo person i interesuar ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës. Pra, investimi i gjykatës është një mjet i shtuar mbrojtjeje dhe i fundit në zinxhirin e masave efektive të cilat mund të ofrohen për mbrojtjen e sinjalizuesit.

Së fundi, ngritja e mekanizmave të duhur për hetimin dhe shqyrtimin e sinjalizimeve është pikërisht një element thelbësor i projektligjit dhe përbën detyrim ligjor jo vetëm për ILDKPKI-në por për të gjitha njësitë përgjegjëse. Së pari, njësitë përgjegjëse janë të detyruara të raportojnë çdo vit tek ILDKPKI-ja për zbatimin e këtij ligji sipas nenit 23 (1) të projektligjit; Së dyti, këto raportime do të përdoren nga ILDKPKI-ja pikërisht për hartimin e rekomandimeve në kuptim të nenit 22 (d) të projektligjit. Projektligji nuk ka parashikuar sanksione për mos respektimin e rekomandimeve të ILDKPKI-së, por ato do të kenë karakter sugjerues dhe shpjegues. Megjithatë, këto rekomandime do t’u vijnë në ndihmë strukturave zbatuese të projektligjit me qëllim përmirësimin e punës së njësite

përgjegjëse/ILDKPKI-së dhe krijimin e një praktike të unifikuar. Së fundi, sipas nenit 22 (a) të projektligjit, ILDKPKI-ja nxjerr udhëzime me efekt detyrues për zbatimin e këtij projektligji brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij projektligji.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj hartohet në mbështetje të neneve 78 dhe 83, paragrafi 1, të Kushtetutës, në zbatim të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, vendimit nr.842, datë 27.9.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë”, si dhe vendimit nr.1012, datë 22.11.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji nuk ka qëllim përafrimin me *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 8 krerë dhe 25 nene.

Kreu I përcakton dispozitat e përgjithshme që përfshijnë objektin qëllimin dhe përkufizimet e termave të projektligjit, të tilla si “sinjalizues”, “i sinjalizuar”, “vepër penale e korrupsionit”, “veprim apo praktikë e dyshuar korrupsionit”, “hakmarrje”, “sinjalizim” etj., si dhe parimet bazë të procesit të sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve.

Kreu II, neni 5, vendos mekanizmin e sinjalizimit si një mjet në dispozicion të çdo personi i cili vihet në dijeni për fakte ose rrethana që përmbajnë apo mund të përmbajnë elemente të veprimeve apo praktikave të dyshuara të korrupsionit, për t’i sinjalizuar te njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja.

Neni 6 përcakton kriteret e vlerësimit të mirëbesimit të sinjalizuesit dhe prezumimin e mirëbesimit në një procedurë sinjalizimi.

Neni 7 sanksionon formën shkresore të kërkuar për depozitimin e sinjalizimit dhe përmbajtjen e sinjalizimit, duke parashikuar edhe mundësinë e sinjalizimit anonim

në raste të veçanta.

Neni 8 përcakton se sinjalizuesi, i cili njofton publikisht veprimin apo praktikën e dyshuar të korrupsionit, do të gëzojë të drejtën e mbrojtjes deri në çastin kur sinjalizimi bëhet publik. Pra mekanizmat e mbrojtjes së sinjalizuesve të veprimeve apo praktikave të korrupsionit nuk do të garantohen më sipas projektligjit nëse sinjalizuesi zgjedh të bëjë publike, përveçse të sinjalizojë te njësia përgjegjëse apo ILDKPKI-ja faktet që disponon.

Neni 9 parashikon mundësinë e bashkëpunimit ndërmjet njësive përgjegjëse me ILDKPKI-në me qëllim shqyrtimin dhe zgjidhjen e një rasti të sinjalizuar kur të sinjalizuarit u përkasin organizatave të ndryshme pavarësisht organizatës së sinjalizuesit. Ky bashkëpunim konsiston në shkëmbim informacionit dhe të dhënash, të plota dhe pa asnjë rezervë, por gjithmonë në zbatim të parimit të ruajtjes së konfidencialitetit, sekretit shtetëror dhe mbrojtjes të të dhënave personale.

Kreu III përcakton ngritjen e strukturave të shqyrtimit të sinjalizimit:

Neni 10 rregullon sinjalizimin e brendshëm pranë njësive përgjegjëse. Në këtë kuptim, pranë çdo autoriteti publik, i cili ka më shumë se 80 të punësuar dhe subjekti privat i cili ka më shumë se 100 të punësuar, caktohet një njësi përgjegjëse e cila do të regjistrojë, do të hetojë dhe do të shqyrtojë sinjalizimet sipas këtij projektligji. ILDKPKI-ja përcakton me udhëzim strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe trajnimin e punonjësve të njësisë përgjegjëse në subjektet private. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim marrëdhëniet e punës, strukturën dhe kriteret e përzgjedhjes së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike.

Neni 11 rregullon sinjalizimin e jashtëm tek ILDKPKI-ja. Mekanizmi i sinjalizimit të jashtëm përdoret në dy raste: sipas pikës 1 të nenit 11, ILDKPKI-ja heton drejtpërdrejt sinjalizimin për veprimet apo praktikat e dyshuara të korrupsionit në organizata të cilat nuk kanë një njësi përgjegjëse për këtë qëllim. Ndërsa sipas pikës 2, të nenit 11, pavarësisht njësisë përgjegjëse brenda organizatës, sinjalizuesi ka të drejtë të sinjalizojë veprën e dyshuar të korrupsionit tek ILDKPKI-ja në rastet e renditura në mënyrë shteruese në këtë nen.

Kreu IV sanksion procedurën e hetimit të sinjalizimit nga njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja:

Neni 12 parashikon parimet e përgjithshme të hetimit.

Nenet 13 dhe 14 përcaktojnë konkretisht procedurën e hetimit nga fillimi i hetimit deri në rastet e mosfillimit apo pushimit të një çështjeje të sinjalizuar. Për aq sa

nuk parashikohet ndryshe në këtë projektligj, njësia përgjegjëse pranë autoritetit publik dhe ILDKPKI-ja zbatojnë dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.

Nenet 15 dhe 16 sanksionojnë dhe rregullojnë mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit dhe të të dhënave personale në përmbajtje të çdo sinjalizimi, si dy parime themelore që ndiqen gjatë gjithë procedurës së shqyrtimit të një rasti të sinjalizuar sipas këtij projektligji.

Kreu V sanksionon të drejtat e sinjalizuesve dhe mjetet e mbrojtjes së sinjalizuesve:

Neni 17 liston të drejtat e sinjalizuesit dhe shtrirjen në kohë të tyre, duke filluar nga procedura e hetimit deri pas përfundimit të hetimit të sinjalizimit, me qëllim kryerjen normale të detyrave funksionale të sinjalizuesit në organizatën e tij. Por këto të drejta garantohen edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës së sinjalizuesit me organizatën e tij, kur nga rrethana të bazuara dhe të arsyeshme sinjalizuesi ka kërkuar mbrojtjen nga ILDKPKI-ja.

Neni 18 liston aktet e hakmarrjes (listë joshteruese) ndaj të cilave sigurohet mbrojtja sipas projektligjit. Çdo akt hakmarrjeje ndaj sinjalizuesit është i pavlefshëm dhe nëse sinjalizuesi dëshiron të vendoset në një strukturë tjetër të organizatës për të ruajtur veten nga reagime armiqësore në mjedisin e tij të afërt të punës, organizata merr masat e arsyeshme dhe të përshtatshme për të lehtësuar një lëvizje të tillë. Në rast të kundërt, ILDKPKI-ja, me kërkesë të sinjalizuesit, i drejtohet organit kompetent sipas legjislacionit në fuqi për të urdhëruar autoritetin publik ose urdhëron subjektin privat të marrë të gjitha masat sipas këtij neni. Nëse organi kompetent apo subjekti privat nuk merr masat e kërkuara nga ILDKPKI-ja, çdo person i interesuar ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës.

Neni 19 sanksionon procedurën e hetimit të kërkesës për mbrojtje të sinjalizuesit.

Neni 20 parashikon se sinjalizuesi ka të drejtë të kërkojë në gjykatë shpërblim për dëmin e pësuar nga akti i hakmarrjes.

Kreu VI vendos shkeljet dhe masat administrative:

Neni 21 sanksionon kundërvajtjet administrative, subjektin përgjegjës dhe masën e gjobës. ILDKPKI-ja ka të drejtë të konstatojë kundërvajtjet dhe të vendosë gjobën sipas rastit.

Kreu VII cakton monitorimin e sinjalizimit:

Neni 22 përcakton funksionet e ILDKPKI-së si institucioni i monitorimit të

projektligjit. Në këtë kuadër, ILDKPKI-ja nxjerr udhëzime të detyrueshme për zbatim në lidhje me mekanizmat e sinjalizimit të brendshëm dhe të jashtëm; kontrollon funksionimin e duhur të mekanizmit të sinjalizimit të brendshëm dhe njësive përgjegjëse të organizatave; konstaton kundërvajtjet administrative dhe vendos gjoba në përputhje me nenin 21, të projektligjit; merr dhe heton kërkesat për mbrojtje ndaj masave hakmarrëse kundër sinjalizuesve dhe garanton mbrojtjen e sinjalizuesit nga masat hakmarrëse; mbi bazën e raporteve vjetore të njësive përgjegjëse harton vlerësime dhe jep rekomandime lidhur me zbatimin e këtij ligji; ofron këshillim dhe mbështetje në lidhje me zbatimin e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve; si dhe do të ketë detyrë të ndërgjegjësojë publikun për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, si dhe të rritë pranimin kulturor të sinjalizimit.

Neni 23 parashikon dy forma raportimesh në lidhje me zbatimin e projektligjit nga njësia përgjegjëse dhe ILDKPKI-ja. Së pari, njësitet përgjegjëse raportojnë pranë ILDKPKI-së çdo vit, jo më vonë se 15 janari i vitit pasardhës, mbi sinjalizimet e regjistruara, mënyrat e ndjekura për hetimin e sinjalizimeve dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Së dyti, ILDKPKI-ja publikon raporte vjetore për zbatimin e projektligjit. Gjithashtu, ILDKPKI-ja, tre vjet pas hyrjes në fuqi të akteve nënligjore në zbatim të projektligjit, do të paraqesë një raport të konsoliduar në Kuvend në lidhje me zbatimin e tij. Pas datës së këtij raportimi të parë, raporti paraqitet në Kuvend çdo dy vjet.

Kreu VIII, nenet 24 dhe 25, rregullojnë përkatësisht nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij projektligji dhe hyrjen në fuqi të tij. Megjithëse parashikohet se projektligji do të hyjë në fuqi 6 muaj pas botimit në “Fletoren zyrtare”, do të zbatohen dy përjashtime për t’i lënë kohë dhe mundësi përgatitjeje ILDKPKI-së dhe njësive përgjegjëse për ngritjen dhe forcimin e mekanizmave për shqyrtimin e sinjalizimeve sipas parimeve dhe kushteve të projektligjit. Në këtë kuadër, sinjalizimi i jashtëm fillon të zbatohet për ILDKPKI-në pas nxjerrjes së akteve nënligjore dhe vënies në dispozicion të burimeve financiare dhe njerëzore të nevojshme për krijimin e strukturës përgjegjëse për zbatim, por jo më vonë se data 1 korrik 2016. Sinjalizimi i brendshëm për subjektet private do të fillojë të zbatohet nga data 1 janar 2017.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen ILDKPKI-ja, të gjitha autoritetet e tjera publike të cilat kanë më shumë se 80 të punësuar dhe subjektet private të cilat kanë më shumë se 100 të punësuar.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji u hartua nga ministri i Shtetit për Çështjet Vendore dhe ministri i Drejtësisë me ndihmën e ekspertëve brenda vendit dhe të huaj, përvoja e të cilëve ka qenë një vlerë e shtuar gjatë hartimit. Projektligji iu nënshtua fazës së konsultimit me të gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë dhe grupet e interesit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji parashikohet të sjellë efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit. Duke marrë parasysh natyrën atipike të pozicionit të kërkuar për njësitë përgjegjëse pranë autoriteteve publike, ku do të zbatohet ligji, do të duhet të riklasifikohen pozicionet ekzistuese të punës në një nivel më të lartë, si pasojë e rishikimit të funksioneve dhe përshkrimit të punës. Ky proces nënkupton rishikimin e përshkrimeve dhe pozicioneve të punës aktuale, duke përfshirë detyrat e reja të pozicionit në çdo përshkrim pune dhe duke përshtatur në këtë mënyrë edhe pagat (për shembull nga niveli III.b në nivel III.a). Rrjedhimisht, efektet buxhetore do të konsistojnë në diferencën e pagës, si pasojë e kalimit në një nivel pozicioni/page më të lartë.

KËSHILLI I MINISTRAVE